

LIGJ
Nr. 105/2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 43/2020, “PËR AKTIVITETET E
TURIZMIT DETAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 43/2020 “Për aktivitetet e turizmit detar” bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, pika 14 ndryshohet si më poshtë:

“14. “Operator i turizmit detar” është ai subjekt, që ushtron aktivitete të turizmit detar, i cili është i certifikuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, sipas parashikimeve të këtij ligji.”.

Neni 2

Në nenin 5 bëhen ndryshimet si më poshtë:

- a) Në pikën 1 fjala “të licencuar” zëvendësohet me fjalën “të certifikuar”;
- b) Pika 2 shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 12, në pikën 1 bëhen ndryshimet si më poshtë:

- a) Fjalët “operator turistik detar” zëvendësohen me fjalët “operator i turizmit detar”.
- b) Fjala “i licencuar” zëvendësohet me fjalën “i certifikuar”.

Neni 4

Në nenin 24 bëhen ndryshimet si më poshtë:

- a) Në pikën 1 në shkronjën “ç” fjala “licencën” hiqet.
- b) Në pikën 3 fjalët “lejes/licencës” hiqen.

Neni 5

Në nenin 25 bëhen ndryshimet si më poshtë:

- a) Pika 2 shfuqizohet.
- b) Në pikën 3 fjalët “sipas pikave 1 dhe 2” zëvendësohen me fjalët “sipas pikës 1”.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 19.9.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 356, datë 10.10.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**